# Pyetësor

## për vlerësimin e ngarkesës psikike
## në vendin e punës ose në lëmin e punës

*Luteni ta plotësoni paraprakisht!*

Lëmi i punës ose veprimtaria

## Fusha e veprimit: Përmbajtja e punës/Detyra e punës (1)

### Çka do të thotë kjo?

Kjo do të thotë, bie fjala:

- Kompletimi i punës
- Hapësira e veprimit
- Ndërrimi
- Përmbajtja e informatës
- Përgjegjësia
- Kualifikimi
- Ngarkesa emocionale

| | | Po, e saktë | Kryesisht po | Kryesisht jo | Jo, aspak |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A i përjetoni ecuritë e punës si të plota, kur i përgatitni, i kryeni dhe në rast nevoje i verifikoni vet ato? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 2 | A i përgjigjen detyrat tuaja kualifikimit dhe njohurive tuaja? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 3 | A i bashkëndërtoni mënyrat dhe procedurat e punës dhe a ju përfshijnë gjatë përzgjedhjes dhe sjelljes së mjeteve të punës? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 4 | A ju qëndrojnë në dispozicion brenda kohës së duhur dhe në vëllim të mjaftueshëm informatat e nevojshme për punën tuaj? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 5 | A keni ndikim në radhimin kohor të veprimtarive tuaja? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 6 | A janë të kuptueshme dhe jokundërthënëse detyrat e punës, të cilat u barten Juve? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 7 | A mund të përballohen në mënyrë të përshtatshme kërkesat emocionale në përditshmërinë tuaj, të cilat burojnë nga kontakti ndërnjerëzor me klinentet dhe klientët, bleréset dhe blerësit dhe me personat nën përkujdesin tuaj? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 8 | Në rast se përballeni me situata, të cilat ju prekin rëndë ose janë të vështira për Ju, bie fjala me dhunë, agresion, fatkeqësi, vuajtje dhe vdekje: A i përballoni ato në mënyrë të përshtatshme në përditshmërinë tuaj profesionale? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |

Tutje faqe 2 »

## Fusha e veprimit: Organizimi i punës (2)

### Çka do të thotë kjo?

Kjo do të thotë, bie fjala:

- Koha e punës
- Radhitjet e punës
- Komunikimi/Bashkëpunimi

| | | Po, e saktë | Kryesisht po | Kryesisht jo | Jo, aspak |
|---|---|---|---|---|---|
| 9 | A mund të planifikohen mirë paraprakisht kohët tuaja të punës së përditshme dhe a janë të përshtatshme planifikimet ose planet e punës? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 10 | A merren parasysh dëshirat tuaja gjatë formësimit të kohës së punës dhe planifikimit të punës? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 11 | A keni kohë të mjaftueshme në dispozicion për punën e përditshme? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 12 | A keni mundësi t'i kryeni detyrat tuaja brenda kohës që ju qëndron në dispozicion, ashtu që të plotësohen kriteret cilësore tuaja personale? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 13 | A mund t'i kryeni detyrat tuaja të punës kryesisht pa u penguar dhe pa ndërprerje? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 14 | A mund t'i bëni pauzat tuaja brenda kohës së duhur, mjaftueshëm dhe pa u penguar në hapësira të përshtatshme? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 15 | A janë të definuara qartë dhe të përkufizuara mirë detyrat, kompetencat dhe autorizimet tuaja? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 16 | Në rast se veproni në kuadër të punës me ndërrime (turne), natën ose në shërbimin e gatishmërisë: A parasheh plani juaj i punës faza të përshtatshme të pushimit dhe të këndelljes? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 17 | Në rast se keni bashkëpunim ndërdisciplinar me koleget dhe me kolegët: A e përjetoni bashkëpunimin tërësisht si konstruktiv? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |

Tutje faqe 3 »

## Fusha e veprimit: Marrëdhëniet shoqërore (3)

### Çka do të thotë kjo?

Kjo do të thotë, bie fjala:

- Bashkëpunimi me kolegët dhe kolegët
- Mbështetje nga udhëheqësia
- Bashkëpunim me udhëheqësinë

| | Po, e saktë | Kryesisht po | Kryesisht jo | Jo, aspak |
|---|---|---|---|---|
| **18** A janë pranë jush kolegët dhe kolegët tuaj kur keni nevojë për mbështetje gjatë punës suaj? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| **19** A e përjetoni atmosferën e punës në ekipin tuaj si të çmueshme dhe mbështetëse? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| **20** A mbështeteni mjaftueshëm nga udhëheqësia juaj, kur keni nevojë? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| **21** A e përjetoni bashkëpunimin me udhëheqësinë tuaj si konstruktiv? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| **22** A ju informojnë brenda kohës së duhur për ndryshimet ose vendimet e ardhshme? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |

## Fusha e veprimit: Ambienti i punës (4)

### Çka do të thotë kjo?

Kjo do të thotë, bie fjala:

- Faktorët fizikal ose teknik
- Faktorët fizik
- Dizajnimi i vendit të punës
- Mjetet e punës

| | Po, e saktë | Kryesisht po | Kryesisht jo | Jo, aspak |
|---|---|---|---|---|
| **23** Ambienti i vendit tuaj të punës është i mbrojtur sa duhet ndaj faktorëve pengues, si: Zhurma, tonet e përhershme sinjalizuese dhe udhëzuese, raportet e pavolitshme të ndriçimit, atmosfera e pakëndshme hapësinore ose kundërmimet? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| **24** A është e garantuar siguria e punës në vendin tuaj të punës, bie fjala gjatë veprimtarive me lëndë të rrezikshme, me rreziqe infektive ose me rreziqe fatkeqësie? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| **25** A e ndieni vendin tuaj të punës të dizajnuar ergonomikisht sa duhet? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| **26** A ju qëndrojnë në dispozicion materiale të përshtatshme dhe mjete të përshtatshme të punës për kryerjen e detyrave tuaja, b.fj. pajisje teknike ose softuer të përgatitur? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |

Tutje faqe 4 »

## Fusha e veprimit: Forma të reja pune (5)

### Çka do të thotë kjo?

Kjo do të thotë, bie fjala:

- Mobiliteti hapësinor
- Marrëdhënie pune jotipike
- Fleksibilizimi kohor

| | | Po, e saktë | Kryesisht po | Kryesisht jo | Jo, aspak |
|---|---|---|---|---|---|
| 27 | A gjendeni në një marrëdhënie të sigurtë pune, në të cilën b.fj. keni një kontratë pune afatgjate ose të pakufizuar? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 28 | A përputhen në mënyrë të përshtatshme kërkesat që u parashtrohen në punën tuaj dhe jeta juaj private? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 29 | Në rast se pyetja vijuese ju përket juve:<br>A mund tu përballoni në mënyrë të përshtatshme kërkesave nga vendet e fleksibilizuara të punës, b.fj. përkitazi vendit të punës ose kohëve të punës? | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |

**BGW-Administrata kryesore**
Pappelallee 33/35/37
22089 Hamburg

Sigurimi ligjor aksidental
Korporatë sipas
të drejtës publike

Tel.: (040) 202 07 - 0
Faks: (040) 202 07 - 24 95
www.bgw-online.de

BGW
Berufsgenossenschaft
für Gesundheitsdienst
und Wohlfahrtspflege